



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada – Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i  
Tehnologije -Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

## **Udhëzim Administrativ**

Për funksionimin e Këshillit për aprovimin e granteve shkollore

**Numër: 15/2009**

**Datë. 28.07.2009**

Në mbështetje të neneve 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4.3 dhe 42.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ :

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të MASHT dhe Bankës Botërore të mbështesë implementimin e Projektit për Zhvillim Institucional në Arsim, respektivisht jetësimin e komponentës 1.3 të projektit “Grantet për zhvillim të shkollave dhe grantet për zhvillim të komunave”, i cili do të ofroj financim të drejtpërdrejt nga projekti IDEP, donacion i Bankës Botërore, për shkollat dhe komunat në Kosovë. Për këtë qëllim MASHT do të themeloj Këshillin për Aprovimin e Granteve Shkollore- KAGSH-n ( në vijim “Këshilli”) i cili do të jetë organ drejtues për komponentën e granteve të projektit IDEP,dhe do të mbikëqyrë, monitoroj dhe këshilloj procesin e granteve të shkollave, në përputhje me doracakun operativ të granteve për zhvillim të shkollave, respektivisht me doracakun operativ të granteve komunale.

## **Neni 2**

### **Definicionet**

1. Për qëllimet e këtij udhëzimit administrativ, do të aplikohen definicionet si në vijim:
  - 1.1. KAGSH: Këshilli për Aprovimin e Granteve të Shkollave
  - 1.2. EKGSH: Ekipi Komunal për Aprovimin e Granteve Shkollore
  - 1.3. KAGK: Këshilli i Arsimit për Grante të Komunave
  - 1.4. EKP: Ekipi koordinues i projektit
  - 1.5. IDEP: Insitution Development Education Project
  - 1.6. BPT: Bashkëpunëtor Profesional i Projektit

## **Neni 3**

### **Funksionet**

1. Këshilli do të ketë dy funksione kryesore: do të jetë organ për aprovimin e shkollave të përzgjedhura në Projektaprovimin e planeve zhvillimore, projektpropozimeve të shkollave për grante si dhe do të shërbej si komitet drejtues për komponentën e granteve për zhvillim të shkollave dhe granteve për zhvillim të komunave.
2. KAGSH, në rolin e organit për aprovimin final të granteve:
  - 2.1. Rishikon dhe aprovon listën e shkollave të përzgjedhura për të marrë pjesë në projektin IDEP- komponentën e granteve për zhvillim të shkollave, të cilin e përgatit dhe dorëzon Ekipi Komunal për Grante Shkollore (EKGSH) dhe Këshilli për Arsim për Grante Komunale (KEGK).
  - 2.2. Rishikon dhe aprovon projektpropozimet e shkollave për grante duke u bazuar në rekomandimet e bëra nga EKGSH dhe KEGK, përmes Ekipit Koordinues të Projektit (EKP), dhe në përputhje me kriteret për aprovimin e propozimeve të shkollave dhe komunave për grante.
  - 2.3. Këshillon EKGSH dhe KEGSH me shkrim përmes EKP për arsyet e ndonjë refuzimi apo të ndonjë rekomandimi për EKGSH, respektivisht KEGSH.
3. KAGSH, në rolin e Komitetit drejtues:
  - 3.1. Rishikon dhe përcjell rregullisht raportet e progresit të hartuara nga EKP që përshkruajnë përparimin dhe problemet rreth jetësimit të granteve për zhvillim të shkollave dhe granteve për zhvillim të komunave.
  - 3.2. Propozon dhe miraton rajonet dhe komunat të cilat do të jenë pjesëmarrëse në jetësimin e Granteve për Zhvillim të Shkollave përkatësisht të Komunave.
  - 3.3. Rekomandon MASHT rreth modifikimeve dhe ndryshimeve me qëllim të përmirësimit të performancës të komponentës të granteve.
  - 3.4. Këshillon MASHT rreth politikave që lidhen me ngritjen e cilësisë në arsim.
  - 3.5. Aprovon doracakun operativ të granteve apo ndonjë amendament të doracakut.

## **Neni 4**

### **Përbërja e Këshillit**

1. Këshilli për aprovimin e granteve shkollore do të përbëhet prej nëntë anëtarëve (shtatë me të drejt vote dhe dy pa të drejt vote).
2. Kryesues i këshillit do të jetë Sekretari i përhershëm në MASHT.
3. Struktura e këshillit për aprovimin e granteve shkollore është:
  - 3.1. Sekretari i përhershëm i MASHT-it ( i emëruar nga Ministri i Arsimit),
  - 3.2. Zyrtar të lartë nga MASHT, të emëruar nga Sekretari i përhershëm,
  - 3.3. Përfaqësues nga UNICEF-i,
  - 3.4. Përfaqësues nga komisioni evropian,
  - 3.5. Përfaqësues nga komunat e Kosovës,
  - 3.6. Përfaqësues nga zyra për komuniteteve në MASHT,
  - 3.7. Koordinator i projektit IDEP (pa të drejtë vote), dhe
  - 3.8. Udhëheqësi i granteve për zhvillim të shkollave, respektivisht të komunave (pa të drejtë vote).
4. Anëtarët e KAGSH, mundësisht duhet të jenë kosovar me mundësi të operimit në të dy gjuhët shqip dhe serbisht.

## **Neni 5**

### **Procedurat e funksionimit të këshillit**

1. Këshilli do të përcjell procedurat standarde të mbledhjeve, duke u bazuar në rregullat procedurale të dhëna në vijim:
  - 1.1. Punët e sekretarisë së këshillit do ti kryej EKP;
  - 1.2. Mbledhjet e këshillit do të thirren nga EKP, në konsultim me Sekretarin e përhershëm;
  - 1.3. Rendi i ditës përcaktohet nga EKP në konsultim me Sekretarin e përhershëm;
  - 1.4. Në rast të mungesës së kryesuesit, anëtarët e mbetur të këshillit do ta zgjedhin një anëtar të KAGSH për të kryesuar mbledhjen;
  - 1.5. Çdo anëtar i këshillit duhet të kundërshtoj pjesëmarrjen në çfarëdo vendimi apo çështje në të cilën ai ose ajo ka konflikt interesi;
  - 1.6. Këshilli do të marrë vendim për çdo çështje që është në mandatin e tij me konsensus, me shumicën e votave;
  - 1.7. Mbledhjet e këshillit do të jenë të vlefshme nëse janë prezent së paku pesë (5) anëtarë;
  - 1.8. Në rast se vendimi nuk mund të merret për shkak të votave të barabarta atëherë do të vendos vota e kryesuesit;
  - 1.9. Vendimet e Këshillit do të paraqiten me shkrim në procesverbal që do të nënshkruhet nga kryesuesi i Këshillit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, i cili e udhëheq mbledhjen e Këshillit;
  - 1.10. Çdo anëtar mund të paraqes ndonjë kërkesë sa i përket procedurës, dhe kryesuesi duhet t'i përmbahet. Nëse dy apo më shumë anëtarë sfidojnë kryesuesin me kërkesa, atëherë kërkesa duhet të vihet në votim.

**Neni 6**  
**Dispozitat shfuqizuese**

1. Më hyrjen në fuqi të këtij u.a shfuqizohet U.A. nr. 8/2008 i datës 16.05.2008 si dhe të gjitha dispozitat tjera të U.A që kanë rregulluar këtë çështje.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi nga data e nënshkrimit.



**Enver Hoxhaj, ministër**